



Nga: Instituti për Politika Zhvillimore

26 Tetor 2017

Për: Deputetët e Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Të nderuar Deputetë të Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Si miq të kahershëm të Komisionit në të cilin ju bëni pjesë, ju dëshirojmë sërish juve dhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (KZHEITI) punë të mbarë në legjislaturën e gjashtë. Instituti INDEP, edhe njëherë shpreh gatishmërinë dhe vullnetin për të punuar bashkë me Komisionin në promovimin e agjendës zhvillimore dhe integruese të shtetit tonë. Jemi të bindur që puna juaj dhe e anëtarëve të tjerë të KZHEITI do të ndihmojë në avancimin e bazës ligjore dhe të rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj Qeverisë dhe agjencive të pavarura.

Siç tashmë jeni në dijeni, Kryeministri i Republikës së Kosovës, me datë 29 shtator, mori vendim për shkarkimin e dhjetë anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.¹ Vendimet, u referoheshin Opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) me numër AKK-DLK-3113/15 të datës 22 shkurt 2016. INDEP bashkë me partnerët GAP dhe GLPS i kemi kundërshtuar këto vendime duke refuzuar përpjekjet për zbatim të pjesshëm të Opinionit të AKK-së dhe të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Për më tepër, për të dalë tek qëllimi i kësaj letre, në mesin e këtyre vendimeve kishte edhe shkarkime në bordin e ndërmarrjes publike KOSTT² ndërmarrje kjo e cila siç e dini, nga viti i kaluar është de-fakto agjenci e pavarur nën kompetencë të Kuvendit.

Të nderuar anëtarë të Komisionit,

Edhe pse emërimi i tyre vërtet ishte në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe për këtë ne e patëm denoncuar rastin në Agjencinë Kundër-Korrupsionit (AKK), vendimi i Kryeministrit është i kundërligjshëm dhe përbën tejkallim të kompetencave të tij. Me miratimin e pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë vitin e kaluar, aksionar i

¹Qeveria e Republikës së Kosovës, (2017), Zyra e Kryeministrit, Vendimet e Mbledhjes së Qeverisë së datës 29 shtator, 2017, e qashmenë http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_5-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017.pdf (qasurnëtetor, 2017)

² Ibid, vendimet Nr.12/05, Nr. 13/05 dhe Nr. 14/05.

KOSTT është Kuvendi i Kosovës i cili emëron dhe shkarkon anëtarët e bordit të KOSTT. Në këtë kuptim, shkarkimi i anëtarëve të KOSTT paraqet ndërhyrje në kompetencat e Kuvendit të Kosovës dhe mund të jetë i dëmshëm për pavarësinë e operatorit dhe pozitën e tij në një treg që tashmë ka filluar të liberalizohet.

Ligji është i qartë dhe kushtëzohet edhe Kuvendin se kur mund të bëjë këtë shkarkim:

Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. (Neni 13.2)

Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur, pas 2 (dy) vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni Funkcional gjen se:

6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë; dhe

6.2. dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të Transmetimit.³(Neni 13.6)

Në diskutimet për miratimin e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, ka qenë përfundim i përbashkët se në funksion të një tregu liberal e konkurrues të energjisë elektrike, nuk mundet i njëjti institucion (Qeveria) të zgjedhë edhe bordet e prodhuesit (KEK) dhe të operatorit të transmisionit (KOSTT). Për këtë dhe pas rekomandimit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, është vendosur që vetëm Kuvendit t'i takoj ky autoritet mbi KOSTT. Vetëm Kuvendi i Kosovës ka autoritet ligjor për shkarkime dhe emërimet në bordin e KOSTT. Ka qenë një obligim i marrë drejtpërdrejtë nga të qenit pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe përpjekjeve për krijim të një tregu liberal.

Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, duke njohur faktin që ndërrimi i aksionarit dhe kompetencave të drejtëpërdrejta mbikëqyrëse nga Qeveria tek Kuvendi, ka paraparë dispozita kalimtare me të cilat sigurohet një tranzicion pa këso ndërhyrje në kompetenca. Neni 62, paragrafi 9 i Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike përcakton shprehimisht:

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët aktual të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, përfshirë Kryesuesin, dhe Komisionin e Auditimit, **vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në përfundimin e mandatit të tyre të rregullt.**⁴

³Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Neni 13, Qeverisjake korporative, kompetencat, raportimi, iqasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744> (qasurnështator, 2017).

⁴Ibit, neni 62, paragrafi 9, faqe 77.

Kjo dispozitë e vënë në Ligjin Nr. 05/L-085, që përbën kornizën e vetme ligjore së cilës i nënshtrohet KOSTT, është vënë pikërisht për të shmangur ndërhyrjet e Qeverisë ndaj një agjencie që tashmë nuk është qeveritare. Ruajtja e balancit të pushteteve është qenësore. Shkeljet ligjore me rastin e emërimit të së paku 18 anëtarëve të bordeve të ndrmarrjeve publike janë evidente dhe të faktuara nga Agjencia Kundër-Korrupsionit, por kjo nuk do të thotë se shkeljet ligjore duhen sanuar me shkelje të reja të ligjit. Për këtë, ju kërkohet juve si anëtarë të Komisionit parlamentar nën ombrellën e së cilit tashmë është KOSTT që të kundërshtoni këtë vendimin joligjor dhe të ngutshëm të Qeverisë dhe të inkuarjoni atë që të ndërmarrë masa për të gjitha rastet tjera për të cilat Qeveria ka juridiksion. Në të njëjtën kohë, Kryeministri duhet të sigurohet se janë marrë masa ndaj atyre që fabrikuan një konkurs të tërë dhe shkelën të drejtat e mbi 1800 kandidatëve që konkuruan në këto konkurse.

Sinqerisht,

Instituti për Politika Zhvillimore